# FLETORJA ZYRTARE
# E
# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

## Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

| Nr. 9 | 2002 | Prill |
|---|---|---|

**P Ë R M B A J T J A**

| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 8811<br>datë 17.5.2001 | Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ........................................................................ | 205 |
| Ligj nr. 8868<br>datë 21.3.2002 | Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Panhellenic Exporters Association për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë”................ | 216 |
| Ligj nr. 8870<br>datë 21.3.2002 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën"...................... | 218 |
| Dekret nr.3280<br>datë 30.3.2002 | Për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm ...................... | 227 |
| Vendim i KM<br>nr. 94, datë 21.3.2002 | Për një shtesë fondi, në Buxhetin e vitit 2002, miratuar për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për shpërblimin e anëtarëve të komisionit të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik ........................................................................... | 227 |
| Vendim i KM<br>nr. 96, datë 21.3.2002 | Për miratimin, në parim, të Marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella ................................................ | 228 |

**LIGJ**
**Nr. 8811, datë 17.5.2001**

# PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

## KREU I

## PËRBËRJA DHE STATUSI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

### Neni 1
**Këshilli i Lartë i Drejtësisë**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën, dhe për kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.

### Neni 2
**Detyrat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ushtron këto detyra:

a) I propozon Presidentit të Republikës emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.

b) Vendos për shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.

c) Vendos për transferimin e gjyqtarëve.

ç) Vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve.

d) Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve.

dh) Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve, kontrollon dhe garanton procesin e vlerësimit dhe shqyrton ankimet e gjyqtarëve për vlerësimin e tyre.

e) Emëron dhe shkarkon, kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.

ë) Emëron dhe shkarkon inspektorët e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

f) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

### Neni 3
**Përbërja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe 9 gjyqtarë, të të gjitha niveleve, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

Neni 4
**Kushtet për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, duhet të jenë gjyqtarë prej jo më pak se 10 vjetësh.
2. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që zgjidhen nga Kuvendi, duhet të jenë juristë me një përvojë jo më pak se 15 vjet në profesion.

Neni 5
**Papajtueshmëritë**

Funksioni i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është i papajtueshëm me funksionin e prokurorit, të anëtarit të organeve drejtuese dhe ekzekutive të partive politike ose me veprimtarinë e avokatisë në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit.

Neni 6
**Kohëzgjatja në detyrë**

1. Anëtarët e zgjedhur qëndrojnë në detyrë për një periudhë 5-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme.
2. Afati i qëndrimit në detyrë i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Lartë të Drejtësisë fillon nga data e zgjedhjes së tyre.
3. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në ushtrimin e këtij funksioni përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7
**Mbarimi i mandatit**

1. Mandati i anëtarit të zgjedhur të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbaron kur:
a) është plotësuar afati 5-vjeçar i qëndrimit në këtë detyrë;
b) jep dorëheqjen;
c) nuk është më gjyqtar, nëse është zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare;
ç) nuk merr pjesë në mbledhjet e këtij Këshilli për një periudhë 6-mujore;
d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
dh) ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që është gjyqtar, është marrë masë disiplinore dhe, pas rivotimit të mandatit të tij në Konferencë Gjyqësore Kombëtare, ai nuk fiton shumicën e votave;
e) deklarohet i paaftë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
ë) vërtetohet njëra nga papajtueshmëritë e përcaktuara nga ky ligj.
2. Në rastet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e anëtarit të ri të tij.
3. Mbarimi i mandatit para afatit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 8
**Plotësimi i vendit vakant në Këshillin e Lartë të Drejtësisë**

1. Plotësimi i vendit vakant në Këshillin e Lartë të Drejtësisë bëhet, sipas rastit, nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare ose Kuvendi.
2. Konferenca Gjyqësore Kombëtare ose Kuvendi mblidhen dhe zgjedhin anëtarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë brenda 45 ditëve nga krijimi i vendit vakant.
3. Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i zgjedhur për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, qëndron në funksion për një mandat të plotë 5-vjeçar.

Neni 9
**Komisioni i Verifikimit të Mandateve**

Në mbledhjen e tij më të afërt, Këshilli i Lartë i Drejtësisë zgjedh një komision të përbërë nga tre anëtarë të dalë prej tij, për të verifikuar zgjedhshmërinë, pajtueshmërinë dhe ushtrimin në përputhje me ligjin të detyrës së anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 10
**Raport i Komisionit të Verifikimit të Mandateve**

1. Raporti i Komisionit të Verifikimit të Mandateve duhet të përmbajë provat dhe argumentet ligjore, sipas rastit, për pajtueshmërinë me ligjin të çështjeve të zgjedhshmërisë, të papajtueshmërisë dhe të ushtrimit të rregullt të mandatit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në përfundim të raportit, Komisioni i Verifikimit të Mandateve i paraqet Këshillit të Lartë të Drejtësisë propozimet përkatëse.

2. Kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë çmon se zgjedhja dhe qëndrimi në detyrë i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk janë në përputhje me ligjin, me vendim të arsyetuar pezullon ushtrimin e mandatit dhe i kërkon, sipas rastit, Konferencës Gjyqësore Kombëtare ose Kuvendit zhvillimin e zgjedhjeve të reja.

KREU II
ORGANIZIMI I KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Neni 11
**Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

1. Presidenti i Republikës është Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Kryetari thërret dhe drejton mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe kujdeset për zbatimin e ligjit gjatë zhvillimit të mbledhjeve dhe për marrjen e vendimeve.

Neni 12
**Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e tij një Zëvendëskryetar.

2. Zëvendëskryetari organizon veprimtarinë e përditshme të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

3. Në rastin kur është zgjedhur nga radhët e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që janë gjyqtarë, Zëvendëskryetari, për kohën që shërben në këtë detyrë, nuk e ushtron funksionin e gjyqtarit.

4. Në rastin e dorëheqjes ose të mbarimit të mandatit, Zëvendëskryetari rifillon ushtrimin e funksionit të gjyqtarit në gjykatën ku ka qenë i emëruar ose, me pëlqimin e tij, në një gjykatë tjetër.

Neni 13
**Detyrat dhe statusi i Zëvendëskryetarit**

1. Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është funksionar me kohë të plotë.

2. Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ushtron këto detyra:

a) Kujdeset për veprimtarinë normale të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

b) Organizon dhe drejton veprimtarinë e Inspektoratit dhe të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

c) Ndjek veprimet e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për verifikimin e ankesave dhe të të dhënave për gjyqtarët dhe për zbatimin e detyrave të ngarkuara nga Këshilli, në rastet e procedimeve disiplinore të filluara nga Ministri i Drejtësisë.

ç) Organizon punën përgatitore për rendin e ditës dhe për zhvillimin normal të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

3. Zëvendëskryetari, në rast mungese ose pengese dhe me autorizim të tij, zëvendëson Kryetarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji.

4. Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë barazohet në pagë me gjyqtarin e Gjykatës së Lartë.

Neni 14
**Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

1. Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë përbëhet nga Kryeinspektori dhe inspektorët. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit dhe numri i inspektorëve përcaktohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

2. Kryeinspektori dhe inspektorët emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e Zëvendëskryetarit.

3. Kandidaturat e inspektorëve përzgjidhen, pas shpalljes publike, ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kushtet për t'u emëruar gjyqtarë në Gjykatat e Apelit dhe, në mungesë të tyre, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet.

4. Veprimtaria e Inspektoratit drejtohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

5. Kryeinspektori organizon dhe përgjigjet për veprimtarinë e përditshme të Inspektoratit.

Neni 15
**Statusi i inspektorëve dhe i kryeinspektorit**

1. Inspektorët emërohen në këtë detyrë për një afat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi.

2. Periudha e ushtrimit të funksionit të inspektorit njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale. Gjyqtarët, që shërbejnë si inspektorë në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë pa konkurs.

3. Kryeinspektori përfiton pagë të njëjtë me Kryetarin e Gjykatës së Apelit të Tiranës, ndërsa inspektorët përfitojnë pagë të njëjtë me gjyqtarët e kësaj gjykate.

Neni 16
**Detyrat e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

1. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka këto detyra:

a) Verifikon ose i dërgon Ministrit të Drejtësisë për trajtim ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera që i drejtohen Këshillit të Lartë të Drejtësisë për veprime të gjyqtarëve, të vlerësuara në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Inspektorati verifikon vetëm ato ankesa të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor ose për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues. Verifikon ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera drejtuar Ministrit të Drejtësisë, të cilat gjykohen prej tij për t'u ndjekur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

b) Verifikimi kryhet vetëm pasi gjyqtari të jetë vënë në dijeni paraprakisht. Inspektorati verifikon nëse ankesat përmbajnë fakte dhe rrethana që mund të përbëjnë shkak ligjor për procedimin disiplinor, si dhe për vlerësimin moral e profesional të gjyqtarëve.

c) Në rastin kur vërehen shkaqe ligjore për procedimin disiplinor, relacioni shpjegues dhe dokumentacioni përkatës, nëpërmjet Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i dërgohen menjëherë Ministrit të Drejtësisë për të gjykuar për procedimin disiplinor.

ç) Kryen verifikime për procedimin disiplinor të propozuar nga Ministri i Drejtësisë, në rastet kur çmohet dhe kërkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Raporti i përgatitur nga Inspektorati paraqitet në mbledhjen e Këshillit nga Zëvendëskryetari.

d) Grumbullon dhe përpunon, në përputhje me kriteret e caktuara sipas ligjit, të dhënat e nevojshme për vlerësimin profesional të gjyqtarëve.

dh) Përgatit vlerësimin për aftësinë profesionale të gjyqtarit. Përpara shqyrtimit të tij nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dokumentacioni i vlerësimit profesional të gjyqtarit i njoftohet paraprakisht gjyqtarit, i cili ka të drejtë të paraqesë me shkrim opinionin e tij së bashku me argumentet përkatëse.

e) Verifikon dhe vë në dukje çështjet për pasuritë e deklaruara nga gjyqtarët, si dhe pajtueshmërinë e veprimtarisë dhe të sjelljes së tyre me kërkesat e përcaktuara në ligj.

2. Në zbatim të detyrave të tij, nëpërmjet Zëvendëskryetarit, Inspektorati kërkon dhe bashkëpunon me Ministrin e Drejtësisë për verifikimin e problemeve të veçanta, në zbatim të detyrave të tij.

3. Inspektorati, në zbatim të ligjit, kryen detyra të tjera, të caktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Neni 17
**Administrata e Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

1. Shërbimet e nevojshme për funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë kryhen nga administrata e tij.

2. Organizimi, struktura dhe numri i punonjësve të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me ligjin, përcaktohen me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

3. Rregullorja e Brendshme e Administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me propozim të Zëvendëskryetarit, miratohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

KREU III
FUNKSIONIMI I KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Neni 18
**Kolegjialiteti**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë i kryen funksionet që i janë ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji, në mënyrë kolegjiale në mbledhjet e tij.

Neni 19
**Thirrja e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

1. Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por jo më rrallë se një herë në 2 muaj. Kryetari mund të vendosë shtyrjen e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Çdo ndryshim, në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet, u njoftohet secilit prej anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Kryetari thërret mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë edhe kur kjo kërkohet me shkrim nga jo më pak se pesë prej anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nga Zëvendëskryetari ose nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 20
**Njoftimi për thirrjen e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

1. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes së Këshillit i bashkëlidhet rendi i ditës dhe materialet e çështjeve për të cilat do të diskutohet në mbledhje.

2. Në qoftë se mbledhja është thirrur me nismën e anëtarëve të tjerë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, thërret mbledhjen.

3. Njoftimet për thirrjen e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë bëhen jo më vonë se 48 orë përpara datës së vendosur për mbajtjen e mbledhjes.

Neni 21
**Mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

1. Në ato raste kur një gjyqtar ndalohet ose arrestohet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mblidhet brenda 24 orëve për të vendosur për lejimin ose jo të procedimit të mëtejshëm penal ndaj gjyqtarit.
2. Këshilli zhvillon mbledhje të jashtëzakonshme edhe në raste të tjera të veçanta, kur çmohet nga Kryetari.

Neni 22
**Rendi i ditës**

1. Rendi i ditës së mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë vendoset nga Kryetari. Në rendin e ditës përfshihen çështje të cilat, sipas ligjit, janë detyrë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
2. Të drejtën për të kërkuar shqyrtimin e çështjeve në rendin e ditës së mbledhjes të Këshillit të Lartë të Drejtësisë e kanë Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë dhe 5 anëtarë të tjerë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Çështjet e rendit të ditës të kërkuara nga Ministri i Drejtësisë shqyrtohen në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
4. Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës bëhet me shkrim, jo më vonë se 2 ditë përpara datës së njoftimit.
5. Rendi i ditës u shpërndahet anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë së bashku me njoftimin për thirrjen e mbledhjes.
6. Përjashtimisht, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të marrë në shqyrtim dhe të vendosë për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës.

Neni 23
**Kuorumi**

Mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 8 anëtarë.

Neni 24
**Votimi i detyrueshëm**

Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar në kuptimin e nenit 37 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", nuk mund të abstenojnë.

Neni 25
**Forma e votimit**

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë i merr vendimet me votim të hapur. Në rastet e votimit për çështje që lidhen me anëtarë të tij, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, mund të vendosë marrjen e vendimeve me votim të fshehtë.
2. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që janë në kushtet e pengesës ligjore, nuk marrin pjesë në diskutimin dhe në votimin e çështjes përkatëse të rendit të ditës.
3. Ministri i Drejtësisë nuk merr pjesë në votim në rastet e procedimeve disiplinore të nisura prej tij, ndërsa Presidenti i Republikës nuk merr pjesë në votim në rastet e propozimeve për emërim të gjyqtarëve.

4. Drejtuesi i mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë voton i fundit.

Neni 26
**Vlefshmëria e vendimeve**

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje.
2. Në rastet kur votat ndahen në mënyrë të barabartë:
a) propozimi për procedim disiplinor quhet i rrëzuar;
b) propozimi për emërim quhet i pranuar.

Neni 27
**Procesverbali i mbledhjes**

1. Zëvendëskryetari merr masat e nevojshme për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
2. Në procesverbal shënohen anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje, çështjet që janë shqyrtuar, diskutimet e pjesëmarrësve, vendimmarrja, forma dhe rezultati i votimeve. Pas shqyrtimit nga anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, procesverbali nënshkruhet nga Zëvendëskryetari.
3. Çdo anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka të drejtë të verifikojë përmbajtjen e procesverbalit dhe të paraqesë objeksionet e veta, të cilat i bëhen të ditura Këshillit të Lartë të Drejtësisë në mbledhjen pasardhëse.
4. Vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, së bashku me procesverbalet përkatëse, depozitohen pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
5. Çdo anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të kërkojë që të shënohet në procesverbal fakti se ai ka votuar kundër vendimit të marrë, si dhe arsyet e votimit kundër.

KREU IV
EMËRIMET DHE TRANSFERIMET E GJYQTARËVE

Neni 28
**Emërimi i gjyqtarëve**

1. Emërimi i gjyqtarëve të shkallë së parë dhe i gjyqtarëve të apelit realizohet në zbatim të kritereve të përcaktuara në ligj, sipas procedurës së mëposhtme:
a) Këshilli i Lartë i Drejtësisë me propozim të Ministrit të Drejtësisë shpall publikisht vendet vakant për gjyqtarë jo më vonë se një muaj para mbledhjes. Shpallja bëhet në të paktën dy gazeta me shpërndarje kombëtare dhe me tirazh të mjaftueshëm, si dhe me anë të radios dhe të televizionit publik. Shpallja duhet të publikohet jo më pak se tri herë, deri në ditën e mbylljes së pranimit të kërkesave.
b) Depozitimi i kërkesave të shoqëruara me dokumentet e kërkuara për pranimin në konkurrim duhet të bëhet nga konkurruesit jo më vonë se dy javë nga dita e fundit e shpalljes publike të vendit vakant.
2. Vendi vakant, si rezultat i shkarkimit të gjyqtarit nga detyra, nuk do të plotësohet në rast se paraqitet ankim në Gjykatën e Lartë. Veprimet e mëtejshme për plotësimin e vendit vakant do të bëhen vetëm nëse Gjykata e Lartë pranon ose rrëzon ankimin.

Neni 29
**Shqyrtimi dhe testimi i kandidatëve konkurrues**

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për plotësimin e vendeve vakante, merr në shqyrtim, diskuton dhe vendos mbi kandidaturat e paraqitura në bazë të shpalljes publike të kryer paraprakisht.

2. Shqyrtimi i kandidaturave bëhet nga një komision i posaçëm i cili kryesohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

3. Komisioni i shqyrtimit të kandidaturave, në bazë të të dhënave të depozituara nga kandidati, bën verifikimin e përmbushjes së kritereve ligjore për t'u emëruar gjyqtar.

4. Pas verifikimit të përmbushjes së kritereve ligjore për konkurrim, komisioni zhvillon testimin profesional të të gjithë kandidatëve.

5. Përbërja, rregullat e funksionimit të komisionit të shqyrtimit të kandidatëve dhe procedurat e verifikimit dhe të testimit të tyre caktohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Neni 30

**Emërimi i gjyqtarit**

1. Në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, çdo anëtari të këtij Këshilli i jepet lista e të gjithë kandidatëve që përmbushin kërkesat ligjore për konkurrim, të dhënat, cilësitë dhe aftësitë e tyre, si dhe rezutatet e testimit individual.

2. Vendimi për t'i propozuar Presidentit të Republikës emërimin e një gjyqtari merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe shpallet publikisht.

## KREU V
## PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 31

**Procedimi disiplinor**

1. Ministri i Drejtësisë kryen inspektimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit për organizimin dhe punën e shërbimeve gjyqësore, administrimin gjyqësor, si dhe realizon e vendos për procedimin disiplinor të gjyqtarëve të tyre.

2. Ministri i Drejtësisë kryen inspektime sipas programeve të posaçme tematike ose territoriale, të hartuara kryesisht ose në zbatim të detyrave të caktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vijim të procesit të verifikimit të ankesave të shtetasve dhe të subjekteve juridike, si dhe sipas të dhënave, për të cilat vihet në dijeni kryesisht ose nëpërmjet Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

3. Në përfundim të inspektimit dhe në bazë të rezultateve të këtij inspektimi, Ministri i Drejtësisë propozon procedimin disiplinor të gjyqtarëve para Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe depoziton dokumentacionin përkatës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

4. Kërkesa për procedimin disiplinor, përveç dokumentacionit me të dhënat përkatëse, të cilat provojnë shkeljen e bërë nga gjyqtari, përmban edhe propozimin për llojin e masës disiplinore që gjykohet se duhet të merret ndaj gjyqtarit të proceduar disiplinarisht.

5. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kur ngarkohet me detyra verifikuese, është i detyruar që, brenda 15 ditëve, të kryej procedurat e verifikimit dhe të depozitojë raportin përkatës.

6. Ministri i Drejtësisë vë në dijeni Këshillin e Lartë të Drejtësisë për rastet dhe për motivet e mosfillimit të procedimit disiplinor të gjyqtarit në kushtet e shkronjës "a" pika 1 e nenit 16 të këtij ligji.

7. Në çdo rast, në përfundim të procesit të verifikimit ose të inspektimit, Ministri i Drejtësisë ose Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet t'i kërkojnë gjyqtarit që procedohet, që të paraqesë me shkrim pretendimet e tij të cilat janë të detyruar t'i pasqyrojnë në dokumentacionin përfundimtar.

Neni 32

**Të drejtat e gjyqtarit që inspektohet**

1. Verifikimi i ankesave dhe inspektimi i gjyqtarit bëhet vetëm pasi ky i fundit të jetë vënë paraprakisht në dijeni.

2. Gjyqtari i proceduar ka të drejtë të njihet me dokumentacionin e procedimit. Marrja dijeni vërtetohet nëpërmjet nënshkrimit të deklarimit përkatës nga gjyqtari i proceduar dhe nga inspektori. Në rast se gjyqtari nuk pranon të nënshkruajë ose nuk gjendet, materialet i bëhen të ditura kryetarit të gjykatës, kundrejt nënshkrimit të këtij të fundit.

Neni 33
**Shqyrtimi i procedimit disiplinor**

Procedimi disiplinor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë zhvillohet si më poshtë:

1. Në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë thirret detyrimisht gjyqtari ndaj të cilit do të shqyrtohet marrja e masave disiplinore, i cili ka të drejtë të mbrohet edhe me avokat. Njoftimi bëhet në një nga mënyrat që parashikon "Kodi i Procedurës Administrative". Mosparaqitja, për shkaqe të paarsyeshme, nuk e pengon Këshillin e Lartë të Drejtësisë të shqyrtojë dhe të vendosë për masën.

2. Në fillim dëgjohet Ministri i Drejtësisë ose sipas rastit Zëvendëskryetari i cili i parashtron Këshillit të Lartë të Drejtësisë shkaqet e procedimit. Më pas dëgjohet gjyqtari që procedohet disiplinarisht, të cilit mund t'i bëhen pyetje nga anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të sqaruar çështjet të cilat kanë nevojë të qartësohen. Diskutimi përfundimtar dhe votimi për marrjen e masave disiplinore, të propozuara nga Ministri i Drejtësisë, bëhen pa praninë e gjyqtarit që procedohet.

3. Rregullimi i hollësishëm i shqyrtimit të procedimit disiplinor caktohet në rregulloren përkatëse të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 34
**Procedurat e ankimit**

1. Ankimi ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit, si dhe për çdo masë tjetër me karakter disiplinor bëhet nga ky i fundit në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e këtij Këshilli.

2. Kryetari ose gjyqtarët e Gjykatës së Lartë të cilët, në cilësinë e tyre si anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kanë marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ku u mor masa disiplinore ndaj ankuesit, nuk marrin pjesë në trupin gjykues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Neni 35
**Procedurat e përfaqësimit**

1. Përfaqësimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në Gjykatën e Lartë, në rastet e ankimit ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, bëhet nga personi i autorizuar nga ky Këshill.

2. Autorizimi për përfaqësim nënshkruhet nga Zëvendëskryetari. Në tekstin e autorizimit tregohet qartë emri i përfaqësuesit dhe çështja konkrete të cilën ai është i autorizuar të përfaqësojë.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 36
**Nënshkrimi i vendimeve**

Vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nënshkruhen nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 37
**Buxheti i Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është person juridik dhe veprimtaria e tij financohet nga Buxheti i Shtetit.

Neni 38
**Qëndrimi në detyrë**

Anëtarët e zgjedhur të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që ushtrojnë këtë funksion në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, qëndrojnë në këtë detyrë deri në mbarim të mandatit të tyre.

Neni 39
**Shfuqizimi**

1.Në ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" shfuqizohen:
Neni 17,
Neni 18 paragrafi i dytë,
Neni 20 paragrafi i shtatë,
Neni 22,
Neni 24 paragrafi i dytë,
Neni 28 paragrafi i pestë,
Neni 44 paragrafi i gjashtë,
Neni 45 paragrafi i tretë.
2. Ligji nr.8316, datë 1.4.1998 "Për miratimin e strukturës të pagave dhe buxhetin për Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 40
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**LIGJ**
**Nr. 8868, datë 21.3.2002**

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE PANHELLENIC EXPORTERS ASSOCIATION PËR KONSOLIDIMIN E BORXHIT TË JASHTËM TË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Panhellenic Exporters Association për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë".

Neni 2

Ligji nr.8748, datë 1.3.2001 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Panhellenic Exporters Association për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë”shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3283, datë 6.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

**MARRËVESHJE**
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PANHELLENIC EXPORTERS ASSOCIATION LIDHUR ME KONSOLIDIMIN E BORXHIT TË JASHTËM TË SHQIPËRISË

Marrëveshje, datë 19.7.2001, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Qeveria), përfqësuar nga Ministria e Financave dhe Panhellenic Exporters Association (PEA).

Neni 1

Subjekt i kësaj Marrëveshjeje është konsolidimi i borxheve, për shumën e papaguar të faturave dhe interesat mbi këto shuma, që rrjedhin nga transaksionet tregtare të përfunduara para 31.12.1991, të mbetura të papaguara deri më 20.10.2000.

Shuma e borxheve është si vijon:

| Emri i Kompanisë | Shuma e faturës së papaguar | Interesi |
|---|---|---|
| 1. M.J.MAILIS S.A. | 30.125,00 DEM | 12.954 DEM |
| 2. HELLENIC STEEL CO. | 251.854,00 USD | 108.095 USD |
| 3. LENCO TRANDING LTD | 23.222,00 USD | 9.376 USD |
| 4. HALCOR S.A. | 11.353,00 USD | 5.010 USD |
| 5. OFITCO S.A. | 14.721,00 USD | 6.496 USD |
| 6. HADJILUCAS S.A. | 12.612,60 USD | 5.565 USD |
| 7. N. LEVENTERIS S.S. | 184,663.88 USD | 81.482 USD |
| 8. D.ZOUKAS & CO. | 116.284,00 USD | 44.333 USD |
| 9. STEFANOS KOLOBOS-DIM KARAPETSOS | 10.200,00 USD | 4.271 USD |
| 10. CARMYCO,N & C.CARAMANIS | 31.302,40 USD | 13.577 USD |
| 11. ELSA S.A. | 370.000,00 DEM | 156.788 DEM |
| 12. GENERAL-IMPORT-EXPORT LTD CO. | 32.533.000,00 GRD<br>dhe 31.372,00 USD | 14.355.186 GRD<br>– 13.843 USD |
| 13.AUSTRO-HELLENIQUE SOCIETE ANONYM TABAC | 56.591,82 USD | 27.517 USD |

Neni 2

Panhellenic Exporters Association heq dorë nga kërkesa e shumës prej 319.565,00 USD, 169.742,00 DEM dhe 14.355.186,00 GRD, që rrjedh nga interesat.

Neni 3

"Qeveria" angazhohet t'i paguajë "PEA" sa më shpejtë të jetë e mundur dhe jo më vonë se 31.10.2001, shumën prej 744.176,70 USD, 400.125,00 DEM dhe 32,533.000,00 GRD.

Neni 4

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit përfundimtar me të cilin të dyja palët do të njoftojnë zyrtarisht përfundimin e procedurave të brendshme të parashikuara nga rregullat respektive.

Bërë më 19.7.2001, në 2 kopje origjinale, në gjuhën anglisht.

| Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë | Panhellenic Exports Association |
|---|---|
| Nga______________ | Nga ___________________ |
| Ministër i Financave | Drejtor |

**LIGJ**
**Nr. 8870, datë 21.3.2002**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7908, DATË 5.4.1995 "PËR PESHKIMIN DHE AKUAKULTURËN"**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2:

1. Shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) Të organizojë menaxhimin në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës nëpërmjet përfshirjes së komuniteteve të peshkimit në proceset e vendimmarrjes dhe të bashkëmenaxhimit të burimeve të peshkimit.".

2. Pas shkronjës "dh" shtohet shkronja "e" si më poshtë:

"e) Të sigurojë funksionimin dhe menaxhimin e porteve dhe të qendrave të peshkimit.".

Neni 2

Në nenin 3, pas shkronjës "g" shtohen shkronjat si më poshtë:

"gj) Me "Organizatë" kuptohet Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, e krijuar sipas nenit 26 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 31/1 të këtij ligji;

h) Me "Port peshkimi" kuptohet një port ose liman që përdoret për peshkim, përfshirë edhe sjelljen në tokë nga mjetet e lundrimit të organizmave ujorë, apo një zonë e përcaktuar brenda një porti tregtar, që përdoret për qëllime të tilla, së bashku me tokën, ndërtesat dhe strukturën përkatëse.

i) Me "Qendër peshkimi" kuptohet një mol, steré, urë në det, valëpritëse ose bankinë, në det ose në ujërat e brendshme, që përdoret për qëllime peshkimi, përfshirë edhe sjelljen në tokë nga mjetet lundruese të organizmave ujorë, së bashku me tokën, ndërtesat dhe strukturat përkatëse.

j) Me "Zonë bashkëmenaxhimi" kuptohet një zonë e peshkimit, e caktuar sipas nenit 31/14 të këtij ligji, ku të paktën një organizatë e menaxhimit të peshkimit merr pjesë në menaxhimin e burimeve të peshkimit.

k) Me "Plan bashkëmenaxhimi" kuptohet një plan për menaxhimin e zonës së bashkëmenaxhimit të peshkimit, që përgatitet në përputhje me dispozitat e pikës 3 të nenit 31/15 të këtij ligji.".

Neni 3

Në pikën 1 të nenit 14 shtohet fjalia e mëposhtme:

"Numri maksimal i licencave të peshkimit dhe të akuakulturës, që jepen për një zonë bashkëmenaxhimi, përcaktohet në planin përkatës të bashkëmenaxhimit.".

Neni 4

Në fund të pikës 1 të nenit 15 shtohen fjalët e mëposhtme:

"me përjashtim të zonave të bashkëmenaxhimit, ku pajisja me licencë peshkimi rregullohet në përputhje me planin e bashkëmenaxhimit.".

Neni 5

Pas pikës 3 të nenit 19 shtohet pika 4 si më poshtë:

"4. Licenca e peshkimit në një zonë bashkëmenaxhimi duhet të jetë në përputhje me përmbajtjen e planit përkatës të bashkëmenaxhimit.".

Neni 6

Në nenin 23, pas shkronjës "d" shtohen shkronjat si më poshtë:

"dh) kur përdoren pushkë nënujore, me pajisjet përkatëse, që sigurojnë frymëmarrjen nën ujë.

e) në zonat e mbrojtura detare.".

Neni 7

Në fund të pikës 1 të nenit 31 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Marrëveshje nuk bëhen për zonat gjeografike, që janë miratuar si zona bashkëmenaxhimi, sipas të njëjtës formë të veprimtarisë së peshkimit.".

Neni 8

Pas nenit 31 shtohen kreret VII/I, VII/II, VII/III si më poshtë:

"KREU VII/I
ORGANIZATAT E MENAXHIMIT TË PESHKIMIT

Neni 31/1
**Organizatat e menaxhimit të peshkimit**

1. Organizatat e menaxhimit të peshkimit janë persona juridikë, privatë, që krijohen në mbështetje të nenit 26 të Kodit Civil, për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e peshkimit, në përputhje me përcaktimet e parashikuara në këtë ligj.

Organizatat e menaxhimit të peshkimit kanë buxhet të pavarur, që bazohet në kuotat e anëtarësisë, donacionet e ndryshme, si dhe nga çdo e ardhur, që realizohet nga veprimtaria e tyre, e parashikuar nga ky ligj. Çdo e ardhur shtesë mbi shpenzimet nuk do të shpërndahet ndërmjet anëtarëve të organizatës, por do të përdoret për realizimin e objektivave të saj.

2. Mbledhja e themelimit miraton statutin e organizatës, mbështetur në statutin tip, dhe zgjedh organet drejtuese të saj. Të paktën gjysma e anëtarëve pronarë, që marrin pjesë në mbledhjen e themelimit, duhet të shprehen dakord me statutin. Projektstatuti i organizatës miratohet nga ministri. Urdhri për miratimin e statutit, së bashku me një kopje të statutit, botohen në Fletoren Zyrtare.

3. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit fiton status juridik pas botimit në Fletoren Zyrtare të urdhrit të ministrit për miratimin e statutit të saj.

4. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit:

a) do të menaxhojë një port ose qendër peshkimi sipas kreut VII/II të këtij ligji;

b) do të marrë pjesë në bashkëmenaxhimin e burimeve të peshkimit, në përputhje me kreun VII/III të këtij ligji.

5. Nuk mund të krijohet më shumë se një organizatë menaxhimi peshkimi për një port ose një qendër peshkimi.

6. Procedurat për themelimin, organizimin dhe funksionimin e organizatës miratohen nga ministri.

Neni 31/2

**Anëtarësia në organizata**

1. Anëtarësia në organizata është vullnetare dhe do të përbëhet nga anëtarë pronarë dhe anëtarë jopronarë.

2. Anëtar pronar ka të drejtë të bëhet mbajtësi i një licence profesionale për një mjet lundrues të regjistruar. Anëtar jopronar ka të drejtë të bëhet çdo kapiten aktiv, inxhinier apo peshkatar, që ka më shumë se dy vjet përvojë në veprimtarinë e peshkimit.

3. Tri të pestat e numrit të përgjithshëm të votave të anëtarëve do të caktohen për anëtarët pronarë të shoqatës, pjesa tjetër e votave do të jetë për anëtarët jopronarë.

Neni 31/3

**Organet e organizatës**

Çdo organizatë ka asamblenë e përgjithshme, këshillin administrativ, si dhe organe të tjera të parashikuara në statut.

Neni 31/4

**Asambleja e përgjithshme**

1. Asambleja e përgjithshme është organi kryesor vendimmarrës i organizatës, që mblidhet të paktën një herë në vit në mbledhjen vjetore të përgjithshme.

2. Mbledhjet e jashtëzakonshme të asamblesë së përgjithshme mund të thirren nga këshilli administrativ, me vullnetin e tij ose në bazë të kërkesës me shkrim të atyre që kanë të paktën 10 për qind të numrit të përgjithshëm të votave ose sipas specifikimit në statut.

3. Asambleja e përgjithshme ka të drejtën ekskluzive të merret me çështjet e mëposhtme:

a) me miratimin e llogarive të raportit vjetor, buxhetit dhe planit të mirëmbajtjes dhe funksionimit;

b) me miratimin e shtesave të propozuara në statut, si dhe me rregulloret e brendshme dhe gjobat për shkeljen e tyre;

c) me zgjedhjen e këshillit administrativ;

ç) me vendimin për shpërndarjen e organizatës;

d) me çështje të tjera, që përcaktohen në statut.

4. Në rastin e anëtarëve pronarë që kanë më shumë se një barkë, statuti parashikon se nuk mund të ketë më shumë se 2/5 e votave që i përkasin anëtarëve jopronarë.

5. Një anëtar ka të drejtë të votojë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme vetëm nëse ka paguar të gjitha detyrimet financiare ndaj organizatës.

Neni 31/5
**Këshilli administrativ**

1. Këshilli administrativ është organi përgjegjës për menaxhimin e organizatës dhe anëtarët e tij janë anëtarë të organizatës. Këshilli administrativ përgjigjet para asamblesë së përgjithshme për mbikëqyrjen e veprimtarisë së organizatës dhe përbëhet të paktën nga tre anëtarë, njëri prej të cilëve është anëtar jopronar i organizatës.

2. Anëtarët e këshillit administrativ zgjidhen me votim të fshehtë në asamblenë e përgjithshme për një periudhë katërvjeçare. Një anëtar i këshillit administrativ, që ka përfunduar mandatin, mund të rikandidojë për t'u zgjedhur. Asnjë person nuk do të zgjidhet në këshillin administrativ nëse ka detyrime financiare ndaj organizatës.

3. Këshilli administrativ ka këto detyra:

a) bën kërkesën për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme;

b) përgatit projektbuxhetin, planin e punës, planin e përdorimit dhe të mirëmbajtjes, që miratohen nga asambleja e përgjithshme;

c) nënshkruan kontratat në përputhje me buxhetin e miratuar, planin e punës dhe planin e përdorimit dhe të mirëmbajtjes;

ç) cakton dhe shkarkon stafin e organizatës;

d) përgatit axhendën e takimeve të asamblesë së përgjithshme;

dh) harton rregulloret e brendshme të organizatës;

e) monitoron punën e organizatës;

ë) siguron ndjekjen e procedurave financiare dhe administrative të organizatës;

f) çështje të tjera, siç përcaktohen në statut.

4. Mbledhjet e këshillit administrativ bëhen çdo muaj ose siç përcaktohet në statut, me kërkesë të kryetarit ose të 1/3 të anëtarëve të këshillit administrativ.

5. Nëse këshilli administrativ pezullohet në përputhje me pikën 3 të nenit 31/7 të këtij ligji, atëherë ministri emëron një drejtues të përkohshëm për të përmbushur detyrimet për mbarëvajtjen e punëve të organizatës deri në mbledhjen pasardhëse të asamblesë së përgjithshme, ku dhe emërohet këshilli i ri administrativ.

6. Drejtuesi i përkohshëm, përveç detyrimeve të përditshme sipas pikës 3 të këtij neni, thërret asamblenë e përgjithshme.

Neni 31/6
**Statuti**

1. Statuti i organizatës duhet të përmbajë të paktën:

a) emrin dhe selinë e organizatës;

b) rregullat e funksionimit të asamblesë së përgjithshme, të këshillit administrativ apo të organeve të tjera;

c) të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të organizatës, të drejtën e votës, tarifat që do të paguhen nga anëtarët;

ç) mënyrën e kontrollit të organizatës për veprimtarinë që kryen;

d) dorëheqjen dhe përjashtimin e anëtarëve dhe sanksionet për shkeljen e statutit;

dh) mënyrën e shpërndarjes dhe të likuidimit të organizatës.

2. Statuti mund të përmbajë edhe dispozita të tjera, të veçanta, për çdo organizatë, por, në çdo rast, pa tejkaluar objektivat e dhënë nga ligji.

3. Për ndryshimet në statut ndiqet e njëjta procedurë si për miratimin e tij.

Neni 31/7
**Komiteti i Monitorimit**

1. Pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit krijohet Komiteti i Monitorimit, prej 7 vetash, i cili raporton te ministri për veprimtarinë e organizatave të menaxhimit të peshkimit dhe të bashkëmenaxhimit të burimeve të peshkimit. Anëtarët e këtij komiteti janë punonjës të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit. Mënyra e funksionimit të këtij komiteti përcaktohet me rregullore të ministrit.

2. Çdo organizatë mban bilancet dhe regjistrat financiarë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe brenda 60 ditëve nga përfundimi i vitit financiar, depoziton kopje të tyre në Komitetin e Monitorimit.

3. Komiteti i Monitorimit, kur zbulon prova të shkeljeve financiare ose vëren se organizata nuk ka vepruar në përputhje me ligjin, njofton këshillin administrativ, i cili thërret menjëherë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, para së cilës paraqiten provat e gjetura nga Komiteti i Monitorimit. Nëse këshilli administrativ nuk e mbledh asamblenë e përgjithshme brenda 30 ditëve, Komiteti i Monitorimit pezullon këshillin administrativ.

Neni 31/8
**Regjistri i organizatave**

1. Ministria krijon regjistrin e organizatave. Rregullat për mbajtjen e regjistrit dhe konsultimin e tij nga publiku përcaktohen nga ministri.

2. Regjistri duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e organizatës;

b) selinë qendrore të organizatës;

c) numrin e anëtarëve të organizatës;

ç) emrat, adresat dhe numrat telefonikë të anëtarëve të këshillit administrativ dhe të kryetarit të çdo organizate;

d) datën e arkivimit të bilancit të fundit vjetor, së bashku me një kopje të tij.

Neni 31/9
**Kontrolli i veprimtarisë së organizatës**

Veprimtaria e organizatës dhe dokumentet e saj kontrollohen nga organet e specializuara të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, si dhe nga organe të tjera, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 31/10
**Shpërndarja e organizatës**

1. Organizata shpërndahet me urdhër të ministrit në rastet e mëposhtme:

a) Kur propozohet nga vetë asambleja e përgjithshme. Në këtë rast vendimi i asamblesë së përgjithshme merret me 2/3 e votave të anëtarëve të organizatës.

b) Kur organet e kontrollit vërejnë se organizata i është shmangur qëllimit për të cilin është krijuar ose nuk është në gjendje të plotësojë, në praktikë, detyrat.

2. Ministri i jep 30 ditë afat organizatës për zgjidhjen e problemeve të vëna re, para se të ushtrojë të drejtën, në përputhje me shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni. Urdhri për shpërndarjen e organizatës botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Me urdhrin për shpërndarje, organizata ndërpret veprimtarinë dhe likuidohet nga komisioni i likuidimeve, i cili krijohet dhe vepron sipas rregullave të përcaktuara në statutin tip.

4. Kundër urdhrit të ministrit për shpërndarjen, organizata ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së urdhrit.

KREU VII/II
DHËNIA NË PËRDORIM E PORTEVE, E QENDVAVE TË PESHKIMIT DHE E STRUKTURAVE QË USHTROJNË VEPRIMTARI PESHKIMI

Neni 31/11
**Transferimi i porteve dhe i qendrave të peshkimit**

1. Një port ose qendër peshkimi dhe strukturat e lidhura me veprimtarinë e peshkimit mund t'i transferohen në administrim një organizate me kërkesën e saj.

2. Kalimi në përdorim i një porti ose qendre peshkimi ose dhe i strukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit, te një organizatë e menaxhimit të peshkimit do të bëhet sipas kritereve të mëposhtme:

a) mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit;

b) garantimin e përdorimit të portit ose qendrës së peshkimit nga ana e shtetit në rastet e masave të jashtëzakonshme;

c) ruajtjen dhe garantimin e interesit publik;

ç) ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike.

3. Format e marrëveshjeve, së bashku me kushtet e përdorimit të porteve ose të qendrave të peshkimit dhe të strukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Organet shtetërore, të ngarkuara nga ligji, kanë të drejtë të inspektojnë infrastrukturën e transferuar, sipas dispozitave të këtij ligji, si dhe dokumentacionin përkatës.

Neni 31/12
**Përdorimi i porteve dhe i qendrave të peshkimit nga organizata**

Një organizatë përdor dhe mirëmban portet ose qendrat e peshkimit që i janë transferuar, në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) administruesit e portit ose të qendrës së peshkimit duhet të përballojnë kostot e përdorimit dhe të mirëmbajtjes;

b) porti ose qendra e peshkimit përdoren në mënyrë të drejtë e të barabartë për të nxitur dhe mbrojtur interesat e përdoruesve;

c) porti ose qendra e peshkimit administrohen në një mënyrë racionale, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, për të nxitur mbrojtjen e mjedisit dhe një zhvillim të qëndrueshëm.

Neni 31/13
**Përdorimi i portit ose i qendrës së peshkimit nga persona joanëtarë të organizatës**

1. Një organizatë është e detyruar të lejojë:

a) çdo mjet lundrues, që është pronë ose drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, të përdorë portin ose qendrën e peshkimit që i është transferuar Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit;

b) personat, të cilët nuk janë anëtarë të organizatës, të hyjnë në port ose në qendrën e peshkimit.

2. Çdo person, i cili hyn ose shfrytëzon portin ose qendrën e peshkimit, që i është transferuar një organizate dhe që nuk është anëtar i saj, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e portit ose të qendrës së peshkimit, dhe me rregulloret e organizatës.

3. Tarifat që organizata ofron për shërbimet për një mjet lundrues, që është pronë a drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, janë më të larta se tarifat për mjetet lundruese të anëtarëve të saj, por, në çdo rast, jo më shumë se dyfishi.

4. Niveli i tarifave propozohet nga organizata dhe miratohet nga ministri.

KREU VII/III
BASHKËMENAXHIMI I PESHKIMIT

Neni 31/14
**Përcaktimi i një zone bashkëmenaxhuese**

1. Si zonë bashkëmenaxhuese e peshkimit miratohet nga ministri çdo hapësirë gjeografike e caktuar e ujërave të Republikës së Shqipërisë, në bazë të kërkesës me shkrim të organizatës. Zona e bashkëmenaxhimit mund të shtrihet për të gjitha veprimtaritë e peshkimit brenda saj ose vetëm në veprimtaritë e peshkimit që përdorin teknika ose mjete gjuetie specifike dhe/ose në periudha të caktuara të vitit.

2. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, e lidhur me një zonë bashkëmenaxhuese, përfshihet në përgatitjen dhe zbatimin e planit të bashkëmenaxhimit për zonën përkatëse.

Neni 31/15
**Planet e bashkëmenaxhimit**

1. Çdo plan bashkëmenaxhimi miratohet për një periudhë jo më shumë se dhjetë vjet dhe ka si qëllim:

a) të nxisë përdorimin e burimeve të peshkimit mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm, duke siguruar, në të njëjtën kohë, mirëmbajtjen e tyre në nivele që arrijnë të plotësojnë nevojat sot dhe në të ardhmen;

b) të mirëmbajë e të ruajë cilësinë dhe llojshmërinë biologjike të burimeve të peshkimit;

c) të nxisë zbatimin e teknologjisë së përshtatshme për peshkim;

ç) të shmangë tejkalimin e kapacitetit të peshkimit.

2. Brenda dymbëdhjetë muajve nga data e caktimit të zonës bashkëmenaxhuese, organizata përkatëse dhe Drejtoria e Peshkimit përgatisin planin e bashkëmenaxhimit të peshkimit për këtë zonë, i cili miratohet nga ministri.

3. Projektplanet e bashkëmenaxhimit hartohen nga Drejtoria e Peshkimit dhe organizata përkatëse, sipas rregulloreve që lëshohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe komisionet e këshillimeve vendore për peshkimin dhe akuakulturën.

4. Planet bashkëmenaxhuese, pas nënshkrimit, botohen në Fletoren Zyrtare, si dhe publikohen në një gazetë që qarkullon në ose pranë zonës bashkëmenaxhuese.

Neni 31/16
**Përmbajtja e planit të bashkëmenaxhimit**

1. Çdo plan bashkëmenaxhimi duhet:

a) të përmbajë një analizë të gjendjes së peshkimit në zonën e bashkëmenaxhimit;

b) të identifikojë objektivat afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë që duhen realizuar, për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm dhe të frytshëm të peshkimit në zonën e bashkëmenaxhimit;

c) të përcaktojë masat e rekomanduara të menaxhimit dhe strategjitë e zhvillimit, të nevojshme për të arritur këta objektiva;

d) të identifikojë burimet e financimit për kostot e zbatimit të këtyre masave menaxhuese;

dh) të përmbajë matës dhe mekanizma zyrtarë kontrolli, në mënyrë që të vlerësohet zbatimi, rregullimi dhe frytshmëria e tij;

e) të përputhet me planin kombëtar për menaxhimin e peshkimit.

2. Një plan bashkëmenaxhimi, që lidhet me një zonë bashkëmenaxhimi, ku përfshihen dy a më shumë organizata, duhet të pasqyrojë me hollësi mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet këtyre organizatave.

Neni 31/17

**Veprimtaria e peshkimit në zonën bashkëmenaxhuese**

1. Aty ku është e nevojshme që të nxitet një menaxhim i frytshëm i peshkimit, plani i bashkëmenaxhimit siguron që:

a) asnjë person të mos ndërmarrë veprimtari peshkimi ose peshkimi profesional në territorin e zonës bashkëmenaxhuese, nëse ai nuk është anëtar i organizatës përkatëse bashkëmenaxhuese;

b) asnjë person të mos ndërmarrë veprimtari peshkimi me pajisje ose teknika të veçanta, nëse ai nuk është anëtar i organizatës përkatëse bashkëmenaxhuese.

2. Për rastet e përmendura në pikën 1:

a) Mbajtësit e licencave të peshkimit profesional do të vazhdojnë të kenë të drejtën për të kryer veprimtari peshkimi për një periudhë deri në një vit pas hyrjes në fuqi të planit të bashkëmenaxhimit.

Pas kësaj periudhe ata duhet të bëhen anëtarë pronarë ose të ndërpresin veprimtarinë e peshkimit në zonën e bashkëmenaxhimit.

b) Anëtarët pronarë të rinj që, me hyrjen në fuqi të ligjit, nuk janë mbajtës të licencave të peshkimit profesional, do të pranohen në organizatë në bazë të kritereve të përcaktuara deri në kapacitetin e parashikuar dhe në përputhje me planin e bashkëmenaxhimit.

Neni 31/18

**Licencimi në një zonë bashkëmenaxhuese**

Një plan bashkëmenaxhimi siguron që dispozitat e nenit 15 të veprojnë në zonën bashkëmenaxhuese ku ai shtrihet dhe, gjithashtu, përcakton sa dhe si organizata ose organizatat përkatëse do të përfshihen në dhënien dhe zbatimin e licencave.

Neni 31/19

**Monitorimi dhe rishikimi**

1. Komisioni për koordinimin e kërkimit shkencor dhe teknologjik mund të kërkojë në çdo kohë një rishikim të zbatimit të çdo plani për bashkëmenaxhimin e peshkimit, në rast se:

a) plani nuk është zbatuar saktë dhe me frytshmëri;

b) zbatimi i planit kërcënon burimet e peshkimit në zonën bashkëmenaxhuese;

c) shkakton konflikte serioze ndërmjet anëtarëve.

2. Ministri, kur shikon se rrezikohen dhe dëmtohen rezervat e peshkimit dhe/ose zonat ujore:

a) urdhëron modifikimin e planit ekzistues të bashkëmenaxhimit dhe/ose mënyrën e zbatimit të tij dhe/ose të detyrimit për zbatim;

b) urdhëron marrjen e masave të veçanta, për zbatimin ose detyrimin në zbatim të planit ekzistues të bashkëmenaxhimit;

c) ndërpret zbatimin e planit ekzistues të bashkëmenaxhimit;

ç) hedh poshtë planin ekzistues të bashkëmenaxhimit.

3. Në rast se një plan bashkëmenaxhimi ndërpritet ose hidhet poshtë, ministri përcakton, në të njëjtën kohë, regjimin e menaxhimit, që zbatohet për këtë lloj peshkimi, dhe nxjerr rregulla të tjera për zbatim.".

Neni 9

Në nenin 32, pas shkronjës "p" shtohen shkronjat e mëposhtme:

"q) procedurat për themelimin e organizatës, përfshirë format dhe përmbajtjen e statuteve;

r) librat, regjistrat që mbahen nga organizatat dhe procedurat financiare;

rr) puna e Komitetit të Monitorimit dhe procedurat e kontrollit;

s) krijimi dhe funksionimi i Komitetit të Monitorimit, përfshirë mbajtjen e regjistrave të organizatave të menaxhimit të peshkimit dhe procedurat e kontrollit që do të ndiqen;

sh) mënyra e përdorimit të porteve dhe e qendrave të peshkimit, që u janë transferuar organizatave.".

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3285, datë 6.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

## DEKRET
## Nr. 3280, datë 30.3.2002

## PËR EMËRIMIN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të nenit 149 pika 1 të Kushtetutës, bazuar edhe në vendimin nr. 22, datë 29.3.2002 të Kuvendit "Mbi dhënien e pëlqimit për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm",

D E K R E T O J:

Neni 1

Zoti Theodhori Sollaku emërohet Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Rexhep Meidani**

## VENDIM
## Nr. 94, datë 21.3.2002

## PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2002, MIRATUAR PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË DEKLARIMIT TË PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.7903, datë 8.3.1995 "Për deklarimin e pasurive të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik" të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", si dhe të nenit 7, të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, t'i shtohet fondi prej 1 980 000 (një milion e nëntëqindetetëdhjetë mijë) lekësh, për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik, për vitet 2001 dhe 2002.

2. Shpërblimi të bëhet sipas vendimit nr. 807, datë 24.12.1998, Këshllit të Ministrave "Për shpërblimin e anëtarëve të komisionit të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik", me ndryshimet përkatëse.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2001.

KRYEMINISTRI
**Pandeli Majko**

**VENDIM**
**Nr. 96, datë 21.3.2002**

## PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SELISË SË SHENJTË PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA

Në mbështetje të neneve 10 pika 5 e 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Pandeli Majko**

## MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SELISË SË SHENJTË PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE RECIPROKE

Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë, duke pasur dëshirën e përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar, në frymën e miqësisë, marrëdhëniet ekzistuese midis tyre,

dhe me qëllim për të rregulluar përmes një marrëveshjeje të përbashkët statusin juridik të Kishës Katolike në Shqipëri,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Republika e Shqipërisë garanton lirinë për të shpallur dhe praktikuar në publik Fenë Katolike.

Kisha Katolike në Shqipëri ka të drejtë të organizohet dhe të plotësojë misionin e saj.

Neni 2

Republika e Shqipërisë njeh zotësinë juridike të personave ligjore për entitete të tilla të Kishës Katolike, të cilat janë të parashikuar në të Drejtën Kanonike, si arqidioqezat, dioqezat apo administraturat apostolike, famullitë, bashkësitë fetare, misionet, shoqatat, seminaret, shkollat dhe institucionet arsimore të të gjitha niveleve, institucionet shëndetësore, mbas regjistrimit të tyre nga organet e drejtësisë.

Neni 3

Selia e Shenjtë dhe Kisha Katolike në Shqipëri gëzojnë lirinë e plotë të komunikimit dhe të korrespondencës me njëra-tjetrën.

Selia e Shenjtë dhe Republika e Shqipërisë do të mbajnë marrëdhëniet diplomatike në nivelin e Munciaturës Apostolike dhe Ambasadës.

Neni 4

Kisha Katolike ka të drejtë të posedojë mjete të veta të komunikimit masiv dhe ka të drejtën të përdorë mjetet publike të komunikimit masiv, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Autoriteti kompetent kishtar ka të drejtë të krijojë strukturat përkatëse të Kishës, e në veçanti të krijojë dhe të modifikojë personat juridikë kishtarë, në përputhje me të Drejtën Kanonike dhe duke respektuar ligjet shqiptare.

Selia e Shenjtë është e lirë të zgjedhë një klerik në detyrën e Ipeshkvit ose të Administratorit Apostolik i cili mund të jetë dhe Ipeshkëv.

Përpara se të publikojë emërimin e Ipeshkvit apo të Administratorit Apostolik, Selia e Shenjtë, për mirësjellje dhe në konfidencë, do të informojë Presidentin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 6

Për të plotësuar përgjegjësitë që rrjedhin nga funksioni baritor, Ipeshkvi ose Administratori Apostolik ka të drejtë të ftojë në Shqipëri priftërinj, anëtarë të kongregacioneve rregulltare dhe persona laikë të cilët nuk kanë nënshtetësinë shqiptare dhe të rekomandojë kërkesën e tyre për leje për rezidencë dhe për leje për punë drejtuar autoriteteve shqiptare, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Me kërkesën formale të Ipeshkvit ose të Administratorit Apostolik, leja për rezidencë dhe leja për punë e nënkuptuar kjo për ushtrimin e aktivitetit baritor do të lëshohen kundrejt një pagese minimale sipas legjislacionit dhe rregullave shqiptare.

Neni 7

Kisha Katolike ka të drejtë të hapë dhe të drejtojë shkollat, klinikat dhe qendrat sociale të saja sipas të Drejtës Kanonike dhe në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Republika e Shqipërisë do të kthejë pronat e Kishës Katolike në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe do të asistojë riregjistrimin e tyre në emrin e Kishës Katolike në në zyrat kompetente shtetërore.

Neni 9

Në rastet e çështjeve të dyshimta, të pazgjidhura dhe të diskutueshme të cilat kanë të bëjnë me Kishën Katolike në Shqipëri në përgjithësi ose me komunitetet apo institucionet katolike në veçanti, Kisha Katolike në Shqipëri dhe autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë do të krijojnë një komision "ad hoc" të përbashkët me detyrën për të gjetur zgjidhje të pranueshme nga të dyja palët.

Neni 10

Nëse në të ardhmen do të lindin vështirësi në lidhje me dispozitat e mësipërme që do të kenë të bëjnë me interpretimin apo aplikimin e tyre, Selia e Shenjtë dhe Republika e Shqipërisë do të procedojë në marrëveshje të përbashkët për një zgjidhje miqësore.

Neni 11

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në momentin e njoftimit reciprok për plotësimin nga Palët të procedurave të tyre të brendshme të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo marrëveshje mund të zgjidhet prej secilës nga Palët që do të njoftojë Palën tjetër për vendimin e saj me shkrim. Marrëveshja do të pushojë së ekzistuari nëntëdhjetë (90) ditë mbas ditës së njoftimit.

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren nr.63, viti 2001 në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.205, datë 24.12.2001, paragrafi i pestë në faqen 1950,

është: Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese për çështje të ndryshme, si dhe qëndrimeve të mbajtura, të cilat vlerësohen për çdo rast konkret, pasi këto vendime kanë efekte inter partes, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se nuk është qëllimi i saj të orientojë dhe të vërë detyra në një praktikë të saj më të konsoliduar për t'i dhënë kuptimin kushtetues të drejtës së individëve për një proces të rregullt ligjor.

bëhet: Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese për çështje të ndryshme, si dhe qëndrimeve të mbajtura, të cilat vlerësohen për çdo rast konkret, pasi këto vendime kanë efekte inter partes, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se nuk është qëllimi i saj të orientojë dhe të vërë detyra për Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por të krijojë dhe të konkludojë në një praktikë të saj sa më të konsoliduar, për t'i dhënë kuptimin kushtetues të drejtës së individëve për një proces të rregullt ligjor.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 20.4.2002
Doli nga shtypi më 22.4.2002

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 4250 copë | Formati: 60x88/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë